



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 26 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1906/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI07/21 dhe KI17/21

Parashtrues

Ali Shabani, Emine Shabani dhe të tjerët

**Vlerësim i kushtetutshmërisë
së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.274/15
të 27 nëntorit 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Ali Shabani, Emine Shabani, Arben Shabani, Ilir Shabani, Sadbere Shabani, Feime Shabani, Naime Shabani, Makfire Shabani, Minivere Shabani dhe Shqipe Shabani nga Gjilani (në tekstin e mëtejme: parashtruesit e kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit e kërkesës kontestojnë kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.274/15 të 27 nëntorit 2020 lidhur me vërtetimin e bashkëpronësisë së paluajtshmërisë së kontestuar.
3. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kontestojnë kushtetutshmërinë: 1) Aktvendimi të Gjykatës Themelore në Gjilan i CN.nr.251/2018, të 31 tetor 2018; 2) Aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.274/15, të 20 shkurtit 2019; 3) Aktvendim të Gjykatës së Apelit CN.nr.101/2019, të 4 nëntorit 2019; 4) Aktvendim i Gjykatës së Apelit, CN.nr.6/2020, të 29 janar 2020; 5) Vendim i Kryetarit të Gjykatës Supreme, GJA.nr.42/2020, të 20 shkurt 2020; 6) Aktvendim i Gjykatës Supreme, GJA.nr.60/2020, të 2 marsit 2020; 7) Vendim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.Nr.73/2020, të 10 prillit 2020; 8) Vendim i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.Nr.215/2020, të 6 gusht 2020.
4. Vendimet e përmendura në paragrafin 3 ndërlidhen me procedurat e zhvilluara nga parashtruesit e kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit V.S., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme.
5. Parashtruesit e kërkesës po ashtu kërkuan caktim të masës së përkohshme “në lëndën me shenjë C.nr.274/15.”

Objekti i çështjes

6. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së: (i) Aktgjykimit Gjykatës Themelore në Gjilan C.nr.274/15 të 27 nëntorit 2020 lidhur me vërtetimin e bashkëpronësisë së paluajtshmërisë së kontestuar; dhe (ii) Vendimeve lidhur me përjashtimin e gjyqtarit V.S., Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme, përmes të cilëve sipas pretendimeve të parashtruesve të kërkesës atyre u janë shkelur të drejtat e tyre të garantuara me nenin 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] dhe në formë të nënkuptuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Baza juridike

7. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

8. Më 11 dhe 18 janar 2021, parashtruesit e kërkesës përmes postës dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).

9. Më 18 janar 2021, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Bekim Sejdiu Gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu-Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
10. Më 1 shkurt 2021, Gjykata në pajtim me rregullin 40 [Bashkimi dhe ndarja e kërkesave] njoftoi parashtruesit për bashkimin e kërkesave KIo7/21 dhe KI17/21 dhe se ato do të shqyrtohen si kërkesë e vetme.
11. Më 1 shkurt 2021, Gjykata njoftoi Gjykatën Themelore në Gjilan për regjistrim të kërkesës KIo7/21 dhe KI17/21.
12. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, Gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 25 qershor 2021.
13. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
14. Më 27 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, përmes Vendimit Nr. K.SH.KIo7/21, caktoi gjyqtarin Safet Hoxha si Gjyqtar raportues në vend gjyqtarit Bekim Sejdiu.
15. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin 4 të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
16. Më 10 nëntor 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhje e fakteve

17. Nga shkresat e lëndës rezulton se Gjykata Themelore në Gjilan përmes Aktvendimit CN.nr.75/14 të 23 prillit 2015 kishte ndërprerë procedurën jo-kontestimore të iniciuar nga propozuesi Sabit Shabani kundër kundër-propozuesve Haqif Shabani, Xhemajl Shabani, Shaip Shabani, për shkak të ndarjes fizike të paluajtshmërisë me ç'rast kishte njoftuar propozuesin që me padi të iniciojë procedurën kontestimore. Gjykata Themelore kishte dalë në vendin e ngjarjes me ekspert gjeodet mirëpo palët nuk kanë mundur të arrijnë marrëveshje për ndarjen e bashkëpronësisë në procedurë jo-kontestimore.
18. Në bazë të shkresave të lëndës rezulton se kundër-propozuesit Haqif Shabani, Xhemajl Shabani, Shaip Shabani janë paraardhësit e parashtruesve të kërkesës.

19. Në bazë të shkresave të lëndës, rezulton se me parashtresat e datave 20 shkurt 2017 dhe 28 shtator 2017 pala paditëse-kundër paditur kishte kërkuar nga Gjykata Themelore në Gjiilan që procedura të vazhdojë kundër Parashtruesve të kërkesës si palë e paditur-kundër paditës.

(i) Procedurat e zhvilluara lidhur me çështjen e vërtetimit të bashkëpronësisë së pahuajtshmërisë së kontestuar

20. Më 27 nëntor 2020, Gjykata Themelore në Gjiilan përmes Aktgjykimit C.nr.274/15 e aprovoi pjesërisht të bazuar padinë e palës paditëse-kundër paditur të paraqitur kundër Parashtruesve të kërkesës.
21. Përmes Aktgjykimit të lartpërmendur, Gjykata Themelore në Gjiilan përcaktoi: **(i) APROVOHET** pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësve- të kundër paditur Shaip Shabani, Fatmir Shabani dhe Xhemajl Shabani e paraqitur kundër të paditurit Haqif Shabani dhe parashtruesve të kërkesës dhe VËRTETOHET se: **a)** paditësit Shaip Shabani dhe Fatmir Shabani janë pronarë me 1/2 pjesë ideale të sipërfaqes prej 3318 m², sipërfaqe kjo në kuadër të ngastrës kadastrale bazë, numër 71-2 ZK Gjiilan; **b)** paditësi Xhemajl Shabani është pronar i sipërfaqes prej 3319 m², në kuadër të ngastrës kadastrale bazë, numër 71-2 ZK Gjiilan; **c)** i padituri Haqif Shabani është pronar i sipërfaqes prej 3319 m², në kuadër të ngastrës kadastrale bazë, numër 71-2 ZK Gjiilan; **d)** parashtruesit e kërkesës janë pronarë me nga 1/11 pjesë ideale të sipërfaqes prej 3319 m², në kuadër të ngastrës kadastrale bazë, numër 71-2; **(ii) REFUZOHET** e pabazuar padia dhe kërkesëpadia e paditësve-kundër të paditurve Shaip Shabani, Fatmir Shabani dhe Xhemajl Shabani e paraqitur kundër të paditurit Haqif Shabani dhe parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se të njëjtit janë pronarë të pjesëve ngastrës kadastrale numër 71-1 ZK Gjiilan; **(iii) REFUZOHET** e pabazuar kundërpadia e parashtruesve të kërkesës, me të cilën kanë kërkuar të vërtetohet e drejta e pronësisë sipas ndarjes gjeodezike të ekspertit gjeodet, ku janë bashkëpronarë të sipërfaqes prej 20.47 m² në kuadër të ngastrës 71-1 dhe njësisë kadastrale 71-2 në sipërfaqe prej 13257 m², ngastra kadastrale këto në zonën kadastrale Gjiilan.
22. Gjykata Themelore arsyetoi se në rastin konkret u vërtetua se paditësit-kundër të paditur Shaip Shabani, Fatmir Shabani dhe Xhemajl Shabani kanë shfrytëzuar që nga viti 1975 pjesët-sipërfaqet e tyre të ngastrës kadastrale nr. 71-2 ZK Gjiilan (si në nënpikën a dhe b të dispozitivit) dhe këto pjesë i kanë shfrytëzuar me mirëbesim, pasi babai i tyre i ndjerë Vesel Shabani ua kishte dhuruar, atëherë mund të vijmë në përfundim se të njëjtit këto pjesë i kanë shfrytëzuar me mirëbesim për më tepër se 35 vite duke u bazuar në nenin 28 të LMTHPJ-së që parashikon se drejta e pronësisë mbi sende fitohet me parashkrim fitues me kalimin e kohës prej 20 vjetësh. Gjykata Themelore se në bazë të shfrytëzimit që nga viti 1975, pushtetin faktik të paditësit-kundër të paditur Shaip Shabani, Fatmir Shabani dhe Xhemajl Shabani i padituri Haqif Shabani dhe parashtruesit e kërkesës kanë ushtruar në sipërfaqet e ngastrës kadastrale nr. 71-2 ZK Gjiilan, me një fjalë e kanë poseduar dhe shfrytëzuar që nga viti 1975 dhe ky posedim shndërrohet në pushtet juridik, prandaj nga kjo

gjendje faktike dhe në bazë të dispozitës ligjore si më lartë, është vendosur si në pikën I, nën-pikat a,b,c dhe d të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

23. Gjykata Themelore arsyetoi se vendosi si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të saj, duke refuzuar kërkesëpadinë e paditësit-kundër të paditur Shaip Shabani, Fatmir Shabani dhe Xhemajl Shabani ku ishte kërkuar që të njëjtit janë pronarë të pjesëve të caktuara të ngastrës nr. 71-1 ZK Gjilan, me arsyetimin se me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar se kjo ngastër faktikisht është ndarë dhe shfrytëzohet në pjesë të caktuara qoftë nga ana e paditësit-kundër të paditur Shaip Shabani, Fatmir Shabani dhe Xhemajl Shabani të paditurit Haqif Shabani apo nga ana e parashtruesve të kërkesës, por nga provat e administruara u vërtetua se kjo ngastër është shfrytëzuar bashkërisht nga të gjithë, por pa u caktuar pjesët se kush cilën e ka shfrytëzuar si në ngastrën nr. 71-2.
24. Gjykata Themelore arsyetoi se vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit të saj, duke refuzuar kërkesëpadinë e parashtruesve të kërkesës me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet e drejta e pronësisë sipas ndarjes gjeodezike të ekspertit gjeodet, ku të njëjtit janë bashkëpronar të sipërfaqes prej 24.70 m2 në kuadër të ngastrës nr.71-1 dhe njësinë kadastrale 71-2 në sipërfaqe prej 13275 m2, ngastra këto në zonën kadastrale në Gjilan, pasi që një kërkesë e tillë nuk ka mbështetje në provat e administruara në këtë proces gjyqësor. Gjykata Themelore shtoi se duke u nisur nga kjo gjendje faktike dhe bazuar në nenin 322 pika 1 dhe 2 të LPK-së, vendosi që ta refuzojë kërkesën e parashtruesve të kërkesës.
25. Gjykata Themelore kishte përcaktuar se kundër aktgjykimit të saj mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në afat prej 15 ditësh.

(ii) Procedurat e zhvilluara lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve

26. Gjykata vëren se në kuadër të çështjes kryesore kontestimore C.nr.274/15 për vërtetim të pronësisë në paluajtshmërinë e kontestuar parashtruesit e kërkesës kanë zhvilluar procedura për përjashtimin e gjyqtarit V.S., nga gjykimi i çështjes kontestimore të tyre. Në tekstin e mëposhtëm do të paraqiten vendimet e gjykatave të rregullta për përjashtimin e gjyqtarit V.S., nga gjykimi i çështjes së parashtruesve të kërkesës. Gjykata po ashtu vëren se mbi bazën e refuzimit për përjashtim të gjyqtarit V.S., parashtruesit e kërkesës po ashtu kanë zhvilluar procedura gjyqësore kundër Kryetarëve të Gjykatës Themelore në Gjilan, Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme.
27. Më 31 tetor 2018, Gjykata Themelore në Gjilan përmes kryetarit R.A., me Aktvendim i CN.nr.251/2018 e refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit V.S., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan, dhe delegimin e çështjes civile juridike C.nr.274/15 tek një gjyqtar tjetër. Gjykata Themelore vlerësoi se kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit V.S., dhe delegimin e lëndës tek një gjyqtar tjetër nuk mund të vlerësohen si rrethana të mjaftueshme për përjashtim të gjyqtarit V.S., sepse nuk janë plotësuar asnjë nga dispozitat e nenit 67 të LPK-së.

28. Më 20 shkurt 2019, Gjykatës Themelore në Gjilan përmes gjyqtarit V.S., me Aktvendim i C.nr.274/15 i 20 shkurtit 2019, e hodhi poshtë të palejuar kërkesa e parashtruesve të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit V.S., gjyqtar në Gjykatën Themelore në Gjilan. Gjykata Themelore vlerësoi se çështja e përjashtimit të gjyqtarit V.S., është vendosur njëherë nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Gjilan sepse bazuar në nenin 69 të LPK-së shprehimisht ceket *“nuk është e lejuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit për kërkesën për të cilën është vendosur një herë”*.
29. Më 4 nëntor 2019, Gjykata e Apelit përmes kryetarit H.SH., me Aktvendim CN.nr.101/2019, refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, për të vendosur lidhur me përjashtimin e gjyqtarit V.S., në çështjen kontestimore C.nr.274/15. Gjykata e Apelit vlerësoi se për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan nuk ekziston asnjë nga shkaqet nga neni 67 i LPK-së, për të vendosur lidhur me përjashtimin e gjyqtarit V.S.
30. Më 29 janar 2020, Gjykata e Apelit përmes kryetarit H.SH., me Aktvendim CN.nr.6/2020, hodhi poshtë të palejuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan. Gjykata e Apelit vlerësoi se kërkesa e parashtruesve të kërkesës është vendosur njëherë me Aktvendimin CN.nr.101/2019 të 4 nëntorit 2019 dhe se bazuar në dispozitën e nenit 69, paragrafi 1, pika b) të LPK-së që përcakton: *“nuk është e lejuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit për kërkesën për të cilën është vendosur një herë”*.
31. Më 20 shkurt 2020, Kryetari i Gjykatës Supreme E.P., me Vendim GJA.nr.42/2020, e hodhi të paafatshme kërkesën e parashtruesve të kërkesës për të përjashtuar Kryetarin e Gjykatës së Apelit nga vendimarrja për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan.
32. Më 2 mars 2020, Gjykatës Supreme, përmes Kryetarit E.P., me Aktvendim GJA.nr.60/2020, refuzoi të pabazuar kërkesën e parashtruesve të kërkesës për delegimin e lëndës C.nr.274/2015 të Gjykatës Themelore në Gjilan për vendosje tek një gjykatë tjetër me kompetencë të njëjtë lëndore. Gjykata Supreme vlerësoi se arsyeja e mos përjashtimit të gjyqtarit V.S., nga kryetari i Gjykatës Themelore nuk mund të merret si shkak që të vendoset që lënda të delegohet tek një gjykatë tjetër, duke arsyetuar më tej, se palët janë nga komuna e Gjilanit, në territorin e së cilës ndodhet Gjykata Themelore në Gjilan, ku është në zhvillim e sipër kontesti ndërmjet palëve në procedurë.
33. Më 10 prill 2020, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me Vendim KGJK.Nr.73/2020, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesve të ushtruar kundër Kryetarit të Gjykatës Supreme. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vlerësoi se ankesa e parashtruesve të kërkesës është e pabazuar dhe se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje disiplinore nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që vendimi i tij është i ligjshëm, objektivisht i paanshëm dhe i pavarur, pa asnjë shenjë paragyrimi dhe i marr brenda kompetencave të tij si Kryetar i Gjykatës Supreme.

34. Më 6 gusht 2020, Këshilli Gjyqësor i Kosovës me Vendim KGJK.Nr.215/2020, refuzoi të pabazuar ankesën e parashtruesve të ushtruar kundër Kryetarit të Gjykatës Supreme. Këshilli Gjyqësor i Kosovës vlerësoi se ankesa e parashtruesve të kërkesës është e pabazuar dhe se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me shkelje disiplinore nga Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, pasi që vendimi i tij është i ligjshëm, objektivisht i paanshëm dhe i pavarur, pa asnjë shenjë paragjykimi dhe i marr brenda kompetencave të tij si Kryetar i Gjykatës Supreme.

Pretendimet e parashtruesve të kërkesës

35. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë shprehimisht shkelje të nenit 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor] të Kushtetutës dhe në formë të nënkuptuar shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës.
36. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: *“Në Gjykatën Themelore në Gjilan në çështjen kontestimore me shenjën C.nr.274/15 për ndarje të bashkëpronësisë, gjyqtari V.S., duke keqpërdorur detyrën zyrtare përmes trajtimit arbitrar të palës kundërpaditëse ka përfunduar shqyrtimin gjyqësor arbitrarisht pa asnjë paralajmërim dhe njoftim të palës kundërpaditëse dhe duke kurdisur lëndën mbi bazën e ekspertizave të manipuluar dhe arbitrarë gjeodezike dhe duke e ndarë Nj.K.nr.71-2 për favorizimin e palës së pandershme S.SH., F.SH., XH.SH., H.SH.”*
37. Parashtruesit e kërkesës theksojnë se kanë kërkuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe nga Kryetari i Gjykatës së Apelit, që në rastin e tyre të sigurohet gjykim i drejtë, i paanshëm, i arsyeshëm si dhe të përjashtohet gjyqtari V.S., nga gjykimi i çështjes së tyre kontestimore. Në këtë kontekst, parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe nga Kryetari i Gjykatës së Apelit nuk u ishin përgjigjur ankesave të tyre lidhur me përjashtimin e gjyqtarit V.S., derisa, ndërkohë, i njëjti gjyqtar-sipas parashtruesve të kërkesës-pa paralajmërim kishte mbyllur shqyrtimin gjyqësor kryesor duke mos u dhënë mundësinë parashtruesve të kërkesës që të paraqesin fjalën përmbyllëse dhe as t'i përdorin mjetet juridike për të kërkuar të drejtën për gjykim të drejtë dhe të arsyeshëm.
38. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë: *“Pala kundërpaditëse në lëndën me shenjën C.nr.274/15 është trajtuar në kundërshtim të plotë me LPK, KRK dhe konventat ndërkombëtare...gjyqtari V.S., ka vepruar në mënyrë arbitrarë dhe në kundërshtim të plotë me nenin 102 të KRK-së [...] në rastin konkret nuk ka pasur fare gjykim sepse ka qenë vetëm një farsë ngase gjyqtari V.S., dhe gjeodeti i favorizuar I.S., kanë vepruar sipas dëshirës duke ndihmuar në kurdisjen e lëndës duke e ndarë Nj.K.nr.71-2 në mënyrë arbitrarë”.*
39. Nga sa më sipër, parashtruesit e kërkesës pohojnë se e bojkotojnë gjyqtarin V.S., për shkak të arbitraritetit të tij dhe se prej datës 05.04.2019 nuk marrin pjesë në shqyrtim gjyqësor. Në këtë vazhde, parashtruesit e kërkesës pohojnë: *“Një ndër mënyrat e kundërshtimit përveçse me procedurat e parapara me ligj është edhe mos nënshkrimi i procesverbaleve, letër-thirrjeve, aktgjykimit arbitrar për të paraqitur vërejtjet, kundërshtimet dhe ankesat e tyre.”*

40. Parashtruesit e kërkesës pohojnë se procedurën për përjashtimin e gjyqtarit V.S., kanë mundur ta vazhdojnë në pajtim me nenin 70.3 të LPK-së mirëpo një veprim i tillë është pamundësuar nga heshtja e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, H.SH. Parashtruesit e kërkesës po ashtu pohojnë se bazuar në dispozitën e nenit 67 (g) dhe 68 të LPK-së kanë mundur ta kërkojnë përjashtimin e gjyqtarit V.S., mirëpo të njëjtit nuk janë njoftuar nga gjyqtari në fjalë nëse është mbajtur seanca e caktuar për datën 16.11.2020.
41. Parashtruesit e kërkesës specifikisht pretendojnë se heshtja dhe mos veprimi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Kryetarit të Gjykatës së Apelit, H.SH., përkitazi përjashtimin e gjyqtarit V.S., është shkelje e rëndë e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe “absurditet i paprecedent”.
42. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga gjykata: (i) që të ndalet trajtimi arbitrar nga Gjykata Themelore në Gjilan dhe të zbatohet Kushtetuta e republikës së Kosovës; (ii) të nxjerrë aktgjykim në lidhje me pretendimet e tyre; dhe, se (iii) kërkojnë vetëm trajtim të barabartë dhe të paanshëm, gjykim të drejtë, të shpejtë dhe të arsyeshëm sepse “në rastin konkret u janë shkaktuar vuajtje shpirtërore, stres enorm emocional, trauma emocionale, dhe dëm financiar”.

Dispozitat ligjore përkatëse

LIGJI Nr. 03/L-006 PËR PROCEDURËN KONTESTIMORE

KREU III

PËRJASHTIMI I GJYQTARIT NGA GJYKIMI

Neni 67

Gjyqtari nuk mund ta procedojë çështjen juridike:

a) në qoftë se është vetë palë, përfaqësues ligjor apo me prokurë i palës, apo në qoftë se me palën është bashkëkreditor apo bashkëdebitor ose i obliguar për regresim, apo në qoftë se në të njëjtën çështje është dëgjuar si dëshmitar ose si ekspert;

b) në qoftë se pala ose përfaqësuesi ligjor apo me prokurë i saj është kushëri gjaku në vijën vertikale deri në cilëndo shkallë, kurse në vijën horizontale deri në shkallë të katërt, apo në qoftë se është bashkëshort, apo gjini e krushqisë deri në shkallë të dytë, pavarësisht nëse martesë ka pushuar ose jo;

c) në qoftë se është kujdestar, adoptues ose i adoptuar i palës, i përfaqësuesit të saj ligjor ose me prokurë;

d) në qoftë se në të njëjtën çështje ka marrë pjese në dhënien e vendimit të gjykatës më të ulët, ose te organit tjetër, ose në procedurën e ndërmjetësimit;

e) në qofte se ka vepruar në çështjen në të cilën është bërë ujdia gjyqësore, e me padinë e ngritur kërkohet anulimi i ujdisë së këtillë;

f) në qoftë se është aksionar apo anëtar i shoqërisë tregtare që është palë në procedurën e iniciuar me padi;

g) në qoftë se ekzistojnë rrethana të tjera që e vejnë në dyshim paanësinë e tij.

Neni 68

68.1 Pala e paraqet kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit posa të ketë mësuar se ekziston ndonjëri nga shkaqet e përjashtimit, por më së voni deri në përfundim të shqyrtimit të çështjes, e nëse nuk ka pasur shqyrtim të saj, atëherë deri në momentin e marrjes së vendimit meritohet.

68.2 Pala mundet në mjetin e goditjes së vendimit përfundimtar apo në përgjigjen në mjetin e goditjes ta emërtoj gjyqtarin që nuk do të mundej të marr pjesë në dhënien e vendimit për shkak të ekzistimit të rrethanave nga neni 67 i këtij ligji.

68.3 Pala mund ta kërkojë përjashtimin e gjyqtarit të caktuar me emër dhe mbiemër që vepron në çështjen konkrete, përkatësisht të kryetarit të gjykatës i cili duhet të vendosë mbi kërkesën për përjashtimin e gjyqtarit.

68.4 Pala ka për detyrë që në kërkesën për përjashtim t'i cekë rrethanat nga të cilat përfundon se ekziston ndonjë bazë ligjore për përjashtimin e gjyqtarit.

Neni 69

69.1 Nuk është e lejuar kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit:

a) me të cilën kërkohet përjashtimi i të gjithë gjyqtarëve të gjykatës që do të mund të gjykonin në një kontest të caktuar;

b) për kërkesën për të cilën është vendosur njëherë;

c) në të cilën nuk është arsyetuar shkak në bazë të të cilit kërkohet përjashtimi.

69.2 Kërkesën nga paragrafi 1 i këtij neni e hedhë poshtë gjyqtari që është duke proceduar çështjen.

69.3 Kundër aktvendimit nga paragrafi 2 i këtij neni nuk lejohet ankesë e posaçme.

Neni 70

70.1 Mbi kërkesën e palës për përjashtimin e gjyqtarit vendosë kryetari i gjykatës.

70.2 Në qoftë se pala e kërkon përjashtimin e kryetarit të gjykatës nga vendosja mbi kërkesën e saj, vendimin për përjashtimin e merr kryetari i gjykatë për një shkallë më të lartë se ajo e çështjes.

70.3 Mbi kërkesën e palës për përjashtimin e kryetarit të Gjykatës Supreme të Kosovës vendosë seanca e përgjithshme e gjyqtarëve të saj.

70.4 Para nxjerrjes së aktvendimit mbi kërkesën për përjashtimin do të merret deklarata e gjyqtarit, përjashtimi i të cilit kërkohet, e sipas nevoje, do të bëhen edhe ekzaminime tjera.

70.5 Kundër aktvendimit me të cilin aprovohet kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk lejohet ankimi, kurse kundër aktvendimit me të cilin refuzohet kërkesa e tillë nuk lejohet ankim i veçantë.

Neni 71

71.1 Gjykatësi posa ta kuptojë së është shtruar kërkesa për përjashtimin e tij ose ekzistojnë shkaqet për përjashtimin e tij sipas nenit 67 të këtij ligji, është i detyruar ta ndërpresë procedimin dhe ta njoftojë kryetarin e gjykatës.

71.2 Përjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, kur kërkesa për përjashtim është bazuar në nenin 67 pika g , gjykatësi e njofton kryetarin e gjykatës dhe mund ta vazhdojë procedimin derisa të vendoset lidhur me kërkesën për përjashtim, vetëm të atyre veprimeve që rrezikohen nga shtyrja

71.3 Kryetari i gjykatës, kur kërkohet përjashtimi i tij, e cakton zëvendësin nga radhët e gjykatësve të gjykatës së çështjes, nëse një gjë e tillë nuk është e mundur, vepron sipas nenit 63 të këtij ligji.

Neni 72

72.1 Dispozitat e këtij ligji për përjashtimin e gjyqtarëve do të zbatohen në mënyrë të përshtatshme edhe ndaj procesmbajtësve.

72.2 Për përjashtimin e procesmbajtësit vendos gjyqtari i çështjes.

ANKESA KUNDEËR AKTGJYKIMIT

E drejta e ankimit

Neni 176

176.1 Kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. Në kontestet nga raportet në të cilat është dhënë aktgjykimi në bazë të kambialit apo çekut, afati për ankim është shtatë (7) ditë.

176.2 Ankimi i bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj pengon që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë në pjesën e goditur me ankim.

176.3 Mbi ankimin kundër aktgjykimit vendosë gjykata e shkallës së dytë.

Neni 182

182.1 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston në çoftë se gjykata gjatë procedurës nuk e ka zbatuar apo ka zbatuar në mënyrë jo të drejt ndonjë dispozitë të këtij ligji, kurse kjo ka pasur apo ka mundë të ketë ndikim në nxjerrjen e aktgjykimit të ligjshëm e të drejtë.

182.2 Shkelja thelbësore e dispozitave të procedurës kontestimore ekziston gjithmonë:

[...]

c) në qoftë se në nxjerrjen e aktgjykimit ka marrë pjesë gjyqtari i cili sipas ligjit duhet të përjashtohet, respektivisht me vendim të gjykatës ka qenë i përjashtuar ose me rastin e dhënies se vendimit ka marrë pjesë personi i cili nuk e ka cilësinë e gjyqtarit.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

43. Gjkata së pari shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës i kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuar me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
44. Gjkata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

“1. Gjkata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

45. Gjkata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesit e kërkesës kanë përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjkata i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që parashikojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tija individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

“Individi mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

46. Gjykata po ashtu i referohet rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës, që specifikon:

“(1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet efektive të përcaktuara me Ligj kundër aktgjykimit ose vendimit të kontestuar.”

(i) Procedurat e zhvilluara lidhur me çështjen e vërtetimit të bashkëpronësisë së paluajtshmërisë së kontestuar

47. Gjykata rikujton se rregulli për shterimin e mjeteve juridike sipas nenit 113.7 të Kushtetutës, nenit 47 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (b) të Rregullores së punës i obligon ata që dëshirojnë të paraqesin rastin e tyre në Gjykatën Kushtetuese që së pari duhet të shfrytëzojnë mjetet juridike efektive në dispozicion në pajtim me ligjin, kundër një aktgjykimi ose vendimi të kontestuar.

48. Në këtë mënyrë, gjykatave të rregullta u jepet mundësia që të korrigjojnë gabimet e tyre përmes procedurave gjyqësore të rregullta para se rasti të vijë në Gjykatën Kushtetuese. Ky rregull bazohet në supozimin e shprehur në nenin 32 të Kushtetutës dhe nenin 13 të KEDNJ-së, që në legjislacionin vendës ka mjete juridike në dispozicion për t'u shfrytëzuar pranë gjykatave të rregullta në lidhje me shkeljen e pretenduar, pavarësisht nëse dispozitat e KEDNJ-së janë inkorporuar në të drejtën nacionale apo jo (shih, rastin e Gjykatës nr. KI19/20, *Parashtrues Lutfi Shantir*, Aktvendim për Papranueshmëri i 22 korrikut 2020, paragrafi 36; dhe shih rastin e GJEDNJ-së, *Aksoy kundër Turqisë*, paragrafi 51 i Aktgjykim i 18 dhjetorit 1996).

49. Parimi është se mekanizmi mbrojtës i krijuar nga Gjykata Kushtetuese të jetë subsidiar në raport me sistemin e rregullt gjyqësor që mbron të drejtat e njeriut (shih, ndër të tjera, *Handyside kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 48 i aktgjykimit të GJEDNJ-së i 7 dhjetorit 1976).

50. Në bazë të nenit 113.7 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës duhet të ketë një rrugë të rregullt deri te mjetet juridike të cilat janë në dispozicion dhe të mjaftueshme për të siguruar një mundësi për të korrigjuar shkeljet e pretenduara. Ekzistimi i mjeteve juridike në fjalë duhet të jetë mjaft i sigurt jo vetëm në teori, por edhe në praktikë, dhe nëse nuk është kështu, atëherë këtyre

mjeteve juridike do t'iu mungojë disponueshmëria dhe efektiviteti i nevojshëm (shih, *inter alia*, *Vernillo kundër Francës*, paragrafi 27 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 20 shkurtit 1991, dhe *Dalia kundër Francës*, paragrafi 38 i Aktgjykimit të GJEDNJ-së i 19 shkurtit 1998).

51. Gjykata duhet të shqyrtojë nëse janë shteruar mjetet juridike dhe nëse mjeti juridik ishte efektiv, në dispozicion në teori dhe praktikë në kohën përkatëse, përkatësisht, që ka qenë i qasshëm, që ka mundur t'i korrigjojë shkeljet në lidhje me kundërshtimet e parashtruesit të kërkesës, dhe gjithashtu ka ofruar një perspektivë të arsyeshme për sukses (shih, *inter alia*, *Civet kundër Francës* paragrafët 42-44 të aktgjykimit të GJEDNJ-së, të 28 shtatorit 1999).
52. Megjithatë, kur një mjet juridik parashikohet me ligj, i takon parashtruesit të kërkesës të dëshmojë se mjeti juridik i paraparë me ligj është shteruar me të vërtetë ose për ndonjë arsye nuk ka qenë në dispozicion dhe ka qenë joefektiv në rrethanat e posaçme të rastit, ose ka pasur rrethana të veçanta për shkak të të cilave ai ose ajo kanë qenë të liruar nga kushti i shterimit të mjeteve juridike (shih rastin KI19/20 *Parashtrues Lutfi Shantir*, cituar më lart, paragrafi 40).
53. Duke iu kthyer rrethanave të rastit konkret, Gjykata vëren se çështja kryesore për vërtetimin e pronësisë të paluajtshmërisë së kontestuar është nxjerrë Aktgjykim i Gjykatës Themelore C.nr.274/15, i 27 nëntorit 2020.
54. Gjykata thekson se Gjykata Themelore kishte përcaktuar se kundër aktgjykimit të saj mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit në afat prej 15 ditësh.
55. Në këtë kontekst, Gjykata i referohet dispozitës relevante të nenit 176 të LPK-së, që parashikon:

“176.1 Kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër [...].”
56. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë njoftuar nëse kanë paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit lidhur me çështjen kryesore kontestimore për vërtetimin e bashkëpronësisë së paluajtshmërisë së kontestuar.
57. Pa paragjykim nëse parashtruesit e kërkesës janë ankuar në Gjykatën e Apelit ose jo, Gjykata vëren se ata nuk kanë ofruar kurrfarë argumenti se mjeti juridik në dispozicion të tyre është joefektiv ose që kanë ekzistuar rrethana të veçanta për shkak të të cilave ata do duhej të liroheshin nga kushti i shterimit të mjeteve juridike (shih rastin KI19/20 *Parashtrues Lutfi Shantir*, cituar më lart, paragrafi 43).
58. Bazuar në sa më sipër, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesve të kërkesës lidhur me çështjen kryesore kontestimore për vërtetimin e bashkëpronësisë të paluajtshmërisë së kontestuar duhet të shpallet e papranueshme, pasi që parashtruesit e kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (b) të Rregullores së punës.

(ii) Procedurat e zhvilluara lidhur me përjashtimin e gjyqtarëve

59. Në këtë aspekt, Gjykata vlerëson nëse lidhur me vendimet e lartcekura janë përmbushur kriteret e përcaktuara me nenin 49 [Afatet] të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës, që përcaktojnë:

*Neni 49
[Afatet]*

Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor... .”

*Rregullin 39 i Rregullores së punës
[Kriteret e pranueshmërisë]*

- (1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit.”

60. Gjykata vëren se procedurat e zhvilluara për përjashtimin e gjyqtarit V.S., më pastaj ndërlidhen me procedurat që janë zhvilluar për përjashtimin e Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme.
61. Gjykata po ashtu vëren se në procedurat e zhvilluara për përjashtimin e gjyqtarit V.S., dhe të Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme kanë rezultuar me një mori vendimesh që kanë përfunduar me Vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, KGJK.Nr.215/2020, të 6 gushtit 2020.
62. Gjykata vëren se kërkesat e bashkuara KI07/21 dhe KI17/21 janë dorëzuar në Gjykatë më 11 janar 2021 deri sa vendimit i fundit i Këshillit Gjyqësor të Kosovës është i 6 gushtit 2020.
63. Nga sa më sipër, rezulton se pretendimi për përjashtimin e gjyqtarit V.S., Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme është dorëzuar jashtë afatit ligjor katër (4) muajsh të parashikuar me nenin 49 të Ligjit dhe specifikuar me rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.
64. Gjykata rikujton se qëllimi i afatit ligjor prej katër (4) muajsh, sipas nenit 49 të Ligjit dhe sipas rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, është që të promovojë siguri juridike, duke siguruar që rastet që kanë të bëjnë me çështje kushtetuese të trajtohen brenda një periudhe të arsyeshme dhe vendimet e mëparshme të mos jenë vazhdimisht të hapura për t'u kontestuar. (Shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së *Sabri Gunes kundër Turqisë*, kërkesa nr. 27396/06, Aktgjykim i 29 qershorit 2012, paragrafi 39; shih gjithashtu, ndër të tjera, rastet

e Gjykatës KI140/13, me parashtrues *Ramadan Cakiqi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 17 marsit 2014, paragrafi 24; dhe KI120/17, me parashtrues *Hafiz Rizahu*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 7 dhjetorit 2017, paragrafi 39).

65. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit V.S., Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme duhet të refuzohen të paafatshme në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

Kërkesa për masë të përkohshme

66. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës kanë kërkuar caktimin e masës së përkohshme *“në lëndën me shenjë C.nr.274/15.”*
67. Gjykata i referohet nenit 27 [Masat e përkohshme] të Ligjit, që parashikon:

“1.Gjykata Kushtetuese sipas detyrës zyrtare ose me kërkesë të palës mund të vendos përkohësisht masa të përkohshme ndaj një çështjeje që është objekt i procedurës, nëse këto masa janë ë nevojshme për të evituar rreziqe ose dëme të pariparueshme, ose nëse marrja e këtyre masave të përkohshme është në interes publik.

2.Kohëzgjatja e masave të përkohshme duhet të jetë e arsyeshme dhe proporcionale”.

68. Gjykata pasi ka konstatuar se parashtruesit i kërkesës nuk i ka shteruar të gjitha mjetet juridike të parapara me ligj lidhur me çështjen kryesore kontestimore për vërtetimin e bashkëpronësisë së paluajtshmërisë së kontestuar, konsideron se parashtruesit e kërkesës nuk kanë treguar rastin *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës.
69. Gjykata refuzon kërkesën për caktimin e masës së përkohshme.

Përfundim

70. Gjykata vlerëson se pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me çështjen kryesore kontestimore (C.nr.274/15) për vërtetimin e bashkëpronësisë së paluajtshmërisë së kontestuar duhet të shpallen të papranueshme për shkak të mos shterimit të të gjitha mjeteve juridike; (ii) pretendimet e parashtruesve të kërkesës lidhur me përjashtimin e gjyqtarit V.S., Kryetarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe të Kryetarit të Gjykatës Supreme duhet të refuzohen të paafatshme dhe (iii) kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet e papranueshme pasi që kërkesa në tërësi është shpallur e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenet 20, 27 47 dhe 49 të Ligjit dhe rregullat 39 (1) (b) dhe (c) dhe 59 (2) të Rregullores së punës, më 10 nëntor 2021, njëzëri:

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA REFUZOJË kërkesën për caktim të masës së përkohshme;
- III. T'UA KUMTOJË këtë aktvendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë aktvendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- V. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Safet Hoxha



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Gresa Caka-Nimani